



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVO-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njesia Org. Org.Jednica Org Unit	5
Nr.i faqeve Br.stranica No. pages	2
Nr. Prot. Prot. No. Date	1750 21.07.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 21.07.2022
Nr. ~~21.07.2022~~
5-1750

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. Ad-3659/22-1 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga BPrAL- kolegji “Rezonanca” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji “Rezonanca”, me seli në Prishtinë në nivel institucional dhe të programeve.
2. Kohëzgjatja e licencës është tri vite (1 tetor 2022 – 30 shtator 2025) në nivel institucional sipas vendimit ref. 476/ 22 të datës 15.04.2022 i lëshuar nga Agjencioni Kosovar i Akreditimi si dhe : Vendimit ref.571/20 të datës 11.09.2020; Vendimit ref.147/20D të datës 11.02.2020; Vendimit ref. 3032/21 të datës 12.08.2021
3. BPrAL- kolegji “Rezonanca”, obligohet që çdo vit ti dëshmoj komisionit për licencim në MASHTI, se ka aplikuar në komunën përkatëse lidhur me përfitimin e lejes së ndërtimit dhe legalizimit.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim të BPrAL/ në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. Ad-3659/22-1 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga kolegji “Rezonanca”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Ky institucion obligohet që çdo vit të sjellë dëshminë te komisioni për licencim se ka aplikuar me kërkesë drejtuar Komunës përkatëse - Drejtoratit për Urbanizëm për përfitimin e lejes së ndërtimit dhe legalizimit.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (1 tetor 2022 – 30 shtator 2025) sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim të cekur në këtë vendim.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi tek Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

